



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës • Republika e Kosovës
Institucion i Avokatit të Popullit
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucioni Ombudsman • Ombudsperson Institution

Numri: 898/2024
Njihet më: 20/12/2024
Ditëtuar në: 20/12/2024



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

A.nr.526/2023

R.nr. 812/2024

R.nr.867/2024

Në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në drejtim të zgjerimit të Listës së Barnave Esenciale, duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të rënda

Drejtuar: Z. Arben Vitia, ministër
Ministria e Shëndetësisë

Kopje: Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministratit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 20 dhjetor 2024

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij rapporti është të bëjë thirrje për Ministrinë e Shëndetësisë që ta zgjerojë listën e barnave esenciale, duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të rënda dhe që kanë nevojë të domosdoshme për trajtim mjekësor më efektiv.

Baza kushtetuese dhe ligjore

2. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekombandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore."
3. Gjithashtu edhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, me përgjegjësitë e përcaktuara me nenin 18. paragrafët 1, 2, 4, 5, 6 dhe 8.
4. Me dërgimin e këtij rapporti tek institucioni përgjegjës, Avokati i Popullit synon t'i kryejë përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore të përmendura më sipër.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

5. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), nisi 7 [Vlerat], paragrafi a, përcakton: "Rendi Kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, pages, demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mos diskriminimit, të drejtës së pronës, [...]."
6. Neni 21 i Kushtetutës përcakton: "Republika e Kosovës mbrojnë dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore [...]."
7. Neni 22 i Kushtetutës, ku janë të radhitura instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut: "Zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konfliktit, ndaj dispozitiveve e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike." Në mesin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare, Avokati i Popullit veçon Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNj).
8. Neni 6 i KEDNj-së [E drejta në një proces të rregullt], paragrafi 1, përcakton: "Çdo person ka të drejtë që çëshja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdoakuze penale në ngarkim të tij [...]."
9. Neni 13 i KEDNj-së përcakton: "Çdo njeri, të cilin i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë përmjet ligjore efektive përmendjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga persona që veprojnë në përbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

Rrethanat e rastit

Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i ka Avokati i Popullit, e të cilat ia kanë ofruar ankuesit dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmblidhen si në vijim:

10. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar tri ankesa të ndara nga: z. Naim Osmani, z. Mufail Salihu dhe

z Hasan Kryeziu, ndaj Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), lidhur me mospërfsirjen e barnave, të cilat, sipas ankuesve, janë esenciale për shëndetin dhe jetën e tyre.

11. Më 4 shtator 2023, Avokati i Popullit e kishte pranuar ankesën e z. Naim Osmanit, i cili përfaqëson Shoqatën për Mbështetje të Personave të Prekur nga Melanoma, dhe ankohej kundër Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) për mosvendosjen e terapisë "braf pozitiv" në Listën e Barnave Esenciale (LBE) për trajtimin e të sëmurëve nga Melanoma.
12. Më 4 shtator 2023, z. Osmanit, në emër të Shoqatës për Mbështetje të Personave të Prekur nga Melanoma, kishte paraqitur ankesë ndaj MSh-së për arsyen e mospërfsirjes së terapisë "braf pozitiv" në Listën e Barnave Esenciale (LBE) për trajtimin e të sëmurëve me melanomë.
13. Në proces të hetimit të ankesës, Avokati i Popullit ishte njoftuar se z. Osmanit kishte ndërruar jetë më 6 mars 2024. Megjithatë, Avokati i Popullit kishte vendosur t'i vazhdonte hetimet lidhur me ankesën e ngritur nga z. Osmanit, në emër të Shoqatës për Mbështetje të Personave të Prekur nga Melanoma.
14. Sipas z. Osmanit, terapia e cila është në LBE, për një kategori të personave me melanomë të avancuar nuk kishte treguar efekt. Ankuesi kishte pohuar se me buxhetin familjar i ishte nënshtruar trajtimit mjekësor në Turqi, me medikamente të avancuara, përkatësisht me terapi "braf pozitiv", terapi qjo që i ishte pëershruar edhe nga onkologu i Klinikës Onkologjike në Kosovë. Sipas z. Osmanit, pas marrjes së kësaj terapi kishte pasur përmirësim të dukshëm të gjendjes së tij shëndetësore.
15. Z. Osmanit kishte njoftuar se kjo terapi kushtonte rreth 4 000 euro në muaj për person dhe se shteti do të duhej të kujdesej që kjo terapi të përfshihej në LBE, në mënyrë që pacientët e prekur me melanomë të avancuar të kishin mundësinë e trajtimit shëndetësor të barabartë me të gjithë të sëmurit e tjerë. Sipas z. Osmanit, shtetet e rajonit këtë terapi e kishin të përfshirë në LBE.
16. Z. Osmanit kishte njoftuar se në emër të shoqatës që përfaqëson, kishte zhvilluar disa takime me përfaqësues të MSh-së dhe kishte kërkuar që barnat, të cilat veçse kishin filluar të jepnin rezultate për të sëmurit nga melanoma, të përfshiheshin në LBE, por që kjo kërkesë nuk ishte marrë parasysh.
17. Lidhur me këtë, më 15 shtator 2023 përfaqësueset e Avokatit të Popullit kishin mbajtur takim me kryesuesin e Komitetit për Revidimin e LBE-së, me ç' rast e kishin njoftuar lidhur me ankesën dhe pretendimet e z. Osmanit si dhe kishin kërkuar informata për mundësinë e revidimit të LBE-së. Kryesuesi kishte njoftuar se në të kaluarën Komiteti për Revidimin e LBE-së rishqyrtonte plotësimin e LBE-së çdo 5 vjet; Komiteti i ri i themeluar me vendim të ministrit të MSh-së, në janar të vitit 2023 kishte arritur të përgatiste draft listën e reviduar, duke u bazuar në tavanin buxhetor dhe në standarde të OBSh-së, e cila pastaj ishte konstituar në muajin shkurt - mars 2023; më 22 maj 2023, ministri i MSh-së kishte nxjerrë vendim, me të cilën e kishte miratuar LBE-në.
18. Kryesuesi i Komitetit për Revidimin e LBE-së kishte njoftuar se buxheti për LBE-në përvitin 2023 ishte rreth 60 milionë euro, nga të cilat 52 milionë euro tashmë ishin harxhuar, sepse kishin qenë të planifikuara për barnat që kishin qenë të përfshira në LBE-në paraprake, e të cilat shtoheshin vazhdimisht. Sipas kryesuesit, gjysma e buxhetit të ShSKUK-së shkonte në Klinikën e Onkologjisë (KO) si dhe shumica e buxhetit të kësaj

klinike shkonte përmes imunoterapi. Ai kishte theksuar se 70 barna të reja ishin aprovuar nga Komiteti përfshirje në LBE dhe se me rastin e futjes së barnave të reja, gjithmonë vlerësohej edhe konteksti shkencor si dhe nëse ato barna ishin në LBE të OBSh-së.

19. Kryesuesi kishte njoftuar se ishin dy mundësi përmes revidimin e listës aktuale të LBE-së, e që ishin: rebalancimi i buxhetit dhe aprovimi i ligjit përmes barnat. Sipas kryesuesit, shkresa që i ishte drejtuar ministrit të MSh-së nga z. Osmani dhe shoqata që ai e përfaqësonte, i ishte përcjellë Komitetit përfshirje në LBE më 30 gusht 2023 dhe kishte njoftuar se kjo kërkesë e tij do të diskutohej edhe në Komitet.
20. Më 2 tetor 2023, përfaqësueset e Avokatit të Popullit kishin mbajtur takim me drejtorin e Klinikës së Onkologjisë në ShSKUK lidhur me ankesën dhe pretendimet e z. Osmanit. Drejtori i kësaj klinike kishte njoftuar se të sëmurët me melanomë malinje të avancuar (metastatike) ishin të mbuluar me terapi mjekësore, ngase ata trajtoheshin me imunoterapi, e cila ishte në LBE, si dhe me kimioterapi, nga e cila, sipas tij, kishte benefacion të vogël. Drejtori kishte njoftuar se Klinika e Onkologjisë kishte buxhet rrëth 13.5 milionë euro dhe përmes 20 persona me melanomë malinje të avancuar, përafërsisht sa mund të janë në nivel vendi, kostojë buxhetore është rrëth 1.5 milion euro në vit.
21. Sipas drejtorit, si onkolog dhe si udhëheqës i Klinikës së Onkologjisë, është mjaft e rëndësishme ta kenë terapinë e nevojshme përmes trajtimit të pacientëve dhe se përfshirja e terapisë "braf pozitiv" në LBE do t'i ndihmonte të sëmurët me melanomë të avancuar. Drejtori kishte njoftuar se edhe vendet e rajonit, siç janë Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, e kanë në LBE terapinë "braf pozitiv" dhe, si profesionist shëndetësor, është pro futjes të terapive të avancuara në LBE në Kosovë.
22. Përmes shumë, drejtori kishte theksuar se dy vjet kolegjumi i Klinikës Onkologjike kishte dërguar kërkesa në Komitetin përfshirje për Revidim të LBE-së përmes futjen e terapisë së avancuar "braf pozitiv" në LBE, por nuk kishte hasur në mirëkuptim. Më tutje ai kishte shtuar se vitin e kaluar nuk e kishte udhëhequr Klinikën Onkologjike dhe nuk kishte pasur kërkesë, por planifikonte edhe në këtë vit që kolegjumi i Klinikës Onkologjike të dërgonte përsëri kërkesë në Komitetin përfshirje për Revidim të LBE-së.
23. Më 10 korrik 2024, Avokati i Popullit i ishte drejtuar me shkresë ministrit të MSh-së, nga i cili kishte kërkuar informata nëse MSh-ja e kishte trajtuar kërkesën përfshirjen e terapisë "braf pozitiv" në LBE, parashtruar qoftë nga Shoqata përfshirje të Personave të Prekur nga Melanoma, nga personeli mjekësor që trajton pacientët me melanomë, apo nga vëtë pacientët, dhe nëse ka pasur ndonjë veprim nga MSh-ja përfshirjen e terapisë "braf pozitiv" në LBE dhe se cili ishte qëndrimi zyrtar i MSh-së lidhur me këtë çështje.
24. Më 23 korrik 2024, Avokati i Popullit nëpërmjet shkresës ishte njoftuar nga ministri i MSh-së se Komiteti Kyç, si mekanizëm i MSh-së përmes revidimin e LBE-së, kishte pranuar kërkesa nga pacientë qoftë në mënyrë individuale, qoftë përmes OJQ-ve, të cilat ishin trajtuar me shumë seriozitet nga komiteti i profesionistëve.
25. Ministri kishte njoftuar se në vitin 2022, Klinika Onkologjike gjatë procesit të revidimit të LBE-së kishte propozuar pako prej 19 produktesh përmes lloje të ndryshme të kancerit, ku shumica absolute e tyre ishin me kosto shumë të lartë dhe se nga llogaritja paraprake kostoja e këtyre 19 produktave do të kushtonte sa gjysma e buxhetit përfshirje në LBE-në; LBE-ja përfshin 850 produkte, përmes të cilave trajtohen mijëra pacientë me sëmundje të

ndryshme; buxheti i LBE-së gjatë revidimit kishte qenë rreth 60 milionë euro, apo gati 100% më shumë se buxheti paraprak; vetëm buxheti për sëmundjet e natyrës onkologjike, ku përfshiheshin edhe ato me melanomë malinje, ishte rritur nga 8 milionë euro në 13 milionë euro; aktualisht numri i produkteve të shtrenjta, të cilat përdoren për trajimin e kancerëve (produkte të target terapisë) në LBE ishte pesë, të aprovuara për 11 indikacione. Sipas ministrit, Komiteti Kyç gjatë revidimit të LBE-së kishte caktuar indikacionet e bazuara në të dhënët shkencore për përdorimin e këtyre produkteve, si dhe kishte vodosur mekanizmin e konsiliumeve, të përberë prej 3 ekspertëve të fushës, për të aprovuar trajimin me terapitë specifike.

26. Ministri kishte njoftuar se Komiteti Kyç, për futjen e produkteve të reja në LBE ishte bazuar në parimet e OBSh-së, të cilat përfshijnë rolin e sëmundjes në shëndetin publik, efikasitetin klinik të produktit (të dokumentuar përmes studimeve cilësore të randomizuara), gama e efektit (efekti në jetëgjatësi, uljen e morbiditetit, uljen e shkallës së hospitalizimit, uljen e shkallës së komplikimeve etj.), kostoefektivitetin dhe kostojat totale e produktit.
27. Po ashtu, në përgjigje thuhej se pacientët me melanomë, të cilët janë "bfar-pozitiv", aktualisht trajtohen në Klinikën Onkologjike me kimioterapi, Kërkesa e Klinikës Onkologjike dhe e shoqatës së pacientëve me melanomë kishte qenë që në LBE të futeshin kombinimet e barnave të reja për këtë grup të pacientëve me melanomë (vemurafenib+cobimetinib dhe dabrafenib+trametinib). Duke shtuar se këto kombinime të barnave kishin koston prej 700 mijë eurosh për vit (për 1 kombinim), Komiteti Kyç gjatë marjes së vendimit për produktet: vemurafenib+cobimetinib dhe dabrafenib+trametinib, cilat përdoren te pacientët me melanomë, kishte konsultuar edhe listën model të barnave të OBSh-së.
28. Më tutje në përgjigje thuhej se propozimet për futjen e këtyre produkteve në listën model të OBSh-së për pacientë me melanomë kishin ardhur gjatë revidimit të kësaj liste më 2021. Paneli i ekspertëve të OBSh-së kishte refuzuar futjen e këtyre produkteve në listë me arsyetimin që gama e efikasitetit (në raport me koston) të këtyre produkteve nuk ishte e nivelet të produkteve aktuale të target terapisë, të cilat gjendeshin në listë (siç janë pembrolizumab dhe nivolumab, të cilat gjendeshin edhe në LBE të Kosovës).
29. Më 20 gusht 2024, Avokati i Popullit kishte pranuar ankesën e z. Mufail Salihajt, i cili ankohej kundër MSh-së për mosdhënen falas të imunoterapisë "pembrolizumab" për trajimin e të sëmurëve me karcinomë metastatike në mëlçi. Sipas z. Salihajt, kjo terapi ishte në LBE, por u jepej falas pacientëve të sëmurë me melanomë dhe kancer të mushkërive.
30. Z. Salihaj kishte njoftuar se para disa muajsh ishte diagnostikuar me diagnozën "*adeno carcinoma në rektum me metastaza në mëlçi*". Më tutje ankuesi kishte shtuar se menjëherë kishte filluar trajimin me kimioterapi dhe ilaçë të tjera përcjellëse. Pas katër seancave me kimioterapi, ankuesi kishte pohuar se onkologu i kishte thënë se duhej të vazhdohej trajtimi me seanca të tjera duke ia shtuar imunoterapinë "pembrolizumab", që sipas pohimeve të ankuesit, onkologu i kishte thënë se duhet ta siguronte vetë, ngase kjo imunoterapi ishte në LBE, por për trajtim të pacientëve me melanomë dhe karcinomë të mushkërive.

31. Z. Salihaj kishte thënë se imunoterapia "pembrolizumab" kushtonte rreth 4 000 euro në muaj për person, të cilën e kishte blerë në rrugë ilegale, ngase nuk kishte mundur ta siguronë në farmaci, e që sipas tij, kjo ngre edhe dyshime nëse ishte duke e marrë ilaçin në gjendje të duhur, nëse ilaçi ishte sjellë në Kosovë sipas kushteve që ky ilaç duhej të ruhej.
32. Për më tepër, z. Salihaj kishte thënë se ai dhe pacientët e tjera të diagnostikuar me karcinomë metastatike në mëlci duhet ta kenë në dispozicion falas këtë terapi, në mënyrë që ta kenë mundësinë e trajtimit shëndetësor të barabartë me të gjithë të sëmurët e tjera.
33. Më 5 shtator 2024, përsaqësuesja e Avokatit të Popullit ka kontaktuar me drejtorin e Klinikës Onkologjike në ShSKUK lidhur me ankesën dhe pretendimet e z. Salihajt. Drejtori i Klinikës Onkologjike ka njoftuar se për sa i përket trajtimit shëndetësor të të sëmurëve me karcinomë metastatike në mëlci, klinika punon në bazë të protokolleve klinike ndërkombëtare, ngase nuk ka protokolle klinike nationale. Më tutje, drejtori ka njoftuar se sipas këtyre protokolleve, trajtimi i kësaj sëmundjeje është i mbuluar me terapi bazike për katër cikle, të cilat janë në LBE. Ndërsa imunoterapia "pembrolizumab" është në LBE, por jo për trajtimin e kësaj sëmundjeje, pra të karcinomës metastatike në mëlci. Por nëse një qendër klinike ndërkombëtare ia rekomandon pacientit këtë terapi, drejtori ka pohuar se edhe Klinika Onkologjike mund ta administrojë terapinë, por pacienti terapinë e siguron vetë.
34. Drejtori i Klinikës Onkologjike ka theksuar se imunoterapia "pembrolizumab" përdoret për trajtimin e kancerit të mushkërive dhe melanomës së avancuar metastatike, sepse është terapi bazike për këto sëmundje.
35. Drejtori ka shtuar se, si Klinikë Onkologjike, kanë propozuar që në LBE të futen barna të tjera, por për shkak të kufizimeve buxhetore nuk është se kanë pasur shumë sukses. Për më shumë, drejtori ka pohuar se këtë terapi nuk e kanë as Mali i Zi, as Serbia, as Maqedonia.
36. Më 10 shtator 2024, Avokati i Popullit ka pranuar ankesën e z. Hasan Kryeziut, parashtruar kundër Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) – Komitetit Kyç për Listën e Produktave Mjekësore dhe Materialit Shpenzues, lidhur me kërkesën që produkti mjekësor - Pirfenidone të përfshihet në listën e barnave mjekësore për trajtimin e indikacionit fibroza e mushkërive idiopatike.
37. Z. Kryeziu ka njoftuar se më 12 dhjetor 2022 ishte diagnostikuar me diagnozën: *Fibrosis pulmonum idiopathica*. Më tutje ankuesi ka shtuar se ai ishte udhëzuar nga Konsiliumi i mjekëve të Klinikës së Pulmologjisë për trajtim me terapi antiifibrinike "Pirfenidone-267 mg", terapi kjo që aktualisht nuk gjendet në tregun kosovar. Z. Kryeziu ka thënë se ka shumë vështirësi ta sigurojë terapinë, të cilën kryesisht e porosit në Turqi dhe se kjo terapi është mjaft e kushtueshme.
38. Sipas z. Kryeziut, sëmundja e tij është një sëmundje e rrallë autoimune dhe se në Kosovë është një numër shumë i vogël i qytetarëve të diagnostikuar me këtë sëmundje, të cilët nuk kanë terapi adekuate. Z. Kryeziu ka vlerësuar se terapia për këta pacientë do të duhej të sigurohej falas, në mënyrë që ta kenë mundësinë e trajtimit shëndetësor të barabartë me të gjithë të sëmurët e tjera.

39. Ankuesi ka pohuar se disa herë i është drejtuar MSh-së me kërkesë që terapia antifibrinike "Pirfenidone" të përfshihet në LBE, por deri më tani nuk ka gjetur mirëkuptim në këtë kërkesë. Në përgjigjen e datës 6 mars 2024, që ai e kishte pranuar nga kryetari i Komitetit Kyç për LBE/MSh ishte njoftuar se më 25 janar 2024 Komiteti Kyç kishte mbajtur takim për të shqyrtuar kërkesën e tij dhe se kishte diskutuar për efikasitetin e produktit të kërkuar. Komiteti Kyç e kishte vlerësuar efikasitetin klinik të produktit për gjendjen përkatëse dhe kishte theksuar se ky produkt nuk e shëronte sëmundjen si dhe nuk kishte profil të favorshëm të kostoefektivitetit. Për më shumë, në përgjigje thuhej se në dritën e këtyre dëshmive dhe për shkak të kufizimeve buxhetore Komiteti Kyç e kishte vlerësuar se në rrëthanat aktuale "Pirfenidone" nuk mund të futej në listën e produkteve mjekësore për indikacionin fibroza mushkërore idiopatike.
40. Më 15 tetor 2024, Avokati i Popullit nëpërmjet shkresës e ka njoftuar drejtorin e Klinikës së Pulmologjisë në ShSKUK lidhur me ankesën dhe pretendimet e z. Kryeziut dhe ka kërkuar informata lidhur me numrin e pacientëve të diagnostikuar me fibrozë mushkërore idiopatike që nga viti 2019; me çfarë terapije trajtohen këta pacientë; nëse terapia gjendet në LBE dhe nëse Klinika e Pulmologjisë i ka propozuar Komitetit Kyç për Listën e Produkteve Mjekësore dhe Materialit Shpenzues që terapinë për trajtim të kësaj sëmundjeje ta përfshinte në LBE, në rast se ajo nuk gjendej në LBE.
41. Më 30 tetor 2024, drejtori i Klinikës së Pulmologjisë e ka njoftuar Avokatin e Popullit se nga viti 2019 e deri tani kanë pasur shumë pacientë me fibrozë pulmonare, por me fibrozë idiopatike pulmonare të diagnostikuar kanë qenë vetëm 5 pacientë. Në njoftim me tej thuhej se trajtimi i kësaj sëmundjeje në Klinikën Onkologjike bëhet në "kortikosteroide", me qëllim të zvogëlimit të progresivit të sëmundjes, e cila në fazat e avancuara të pacientët shkaktojnë insuficiencë të rëndë respirator. Gjithashtu në njoftim thuhej se viteve të fundit janë aprovuar nga FDA-ja barnat antifibrotike, të tilla si: tBL.Nintedanib dhe tBL.Pirfenidon, në zvogëlimin e përkeqësimit të sëmundjes.
42. Drejtori ka njoftuar se pacientët me sëmundje fibroze të mushkërive trajtohen me kortikosteroide, e cila terapi gjendet në LBE, ndërsa për barnat antifibrotike të aprovuara nga FDA-ja dhe të aplikuara viteve të fundit te pacientët me fibrozë idiopatike pulmonare ka shumë diskutime lidhur me kostobenefitin e tyre dhe se në Kosovë nuk janë në LBE. Drejtori ka njoftuar se kanë parashtruar kërkesë në Komitetin Kyç për përfshirjen e terapisë antifibrotike në LBE, por kanë marrë përgjigje negative për shkak të kostobenefitit të saj.
43. Pacientët e diagnostikuar me fibrozë idiopatike pulmonare nuk kanë terapi antifibrotike, por sipas përgjigjes së drejtorit të Klinikës së Pulmologjisë, ata trajtohen me terapi të njëjtë sikurse trajtohen pacientët me diagnozë fibrozë pulmonare. Terapia (kortikosteroide) për pacientët me diagnozë fibrozë pulmonare gjendet në LBE, ndërsa pacientët me diagnozë fibrozë idiopatike pulmonare udhëzohen të përdorin terapi antifibrinike "Pirfenidone-267 mg", të cilën duhet ta sigurojnë vetë.

PRAKTIKA E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

44. Duke marrë parasysh se sipas nenit 53 të Kushtetutës, të drejtat njeriut dhe lirite themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), Avokati i Popullit, me qëllim të formësimit të qëndrimit lidhur me ankesat e paraqitura, u referohet disa akt gjykimeve të

kësaj gjykate, të cilat trajtojnë të drejtën për jetë sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), e drejtë kjo e garantuar edhe me nenin 25 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të drejtën për ndalim të diskriminimit sipas nenit 14 të KEDNj-së, e drejtë kjo e garantuar edhe me nenin 24 të Kushtetutës:

- *Panaitescu kundër Rumanisë (2012)*

Më 20 prill 2005, aplikuesi ishte diagnostikuar me kancer dhe më 4 maj 2005 ai i ishte nënshtruar një operacioni për heqjen e një tumorit në veshkë. Pas analizave mjekësore ishte konstatuar se tumorit kishte arritur stadin III dhe se ishte prekur edhe mushkëria. Sipas kërkuesit, megjithëse ishte i shtruar në Reparin Onkologjik, stafi mjekësor nuk kishte arritur t'ia administronte atij terapinë specifikë onkologjike dhe ai ishte trajtuar me perfuzione me vitamina dhe tretësirë të thjeshtë të kripur.

Në këto rrethana kërkuesi, sipas rekomandimit të një mjeku onkolog në Spitalit Oradea, kishte nisur trajtimin me ilaçet Avastin dhe Roferon. Mjeku kishte konfirmuar një remision të pjesshëm të sëmundjes në rastin e aplikuesit, prandaj kishte rekomanduar vazhdimin e trajtimit, i cili kishte qenë i administruar te pacienti dy herë në javë nga 1 korriku 2005, kishte qenë i siguruar dhe i paguar plotësisht nga z. Panaitescu gjatë gjithë periudhës së trajtimit.

Mirëpo, pasi ai nuk mund ta përballonte koston e trajtimit, kërkuesi kishte paraqitur kërkësë për rimbursimin e shpenzimeve. Gjykatat vendase, si në shkallë të parë, ashtu edhe në apel, ishin shprehur në të mirë të kërkuesit dhe kishin urdhëruar autoritetet shtetërore t'ia siguronin atij mjekimin antikancer të përshkruar dhe t'ia rimbursonin çdo kosto lidhur me trajtimin e sëmundjes. Për më tepër, gjykatat e kishin hedhur poshtë argumentin e autoriteteve shtetërore, sipas të cilëve, Avastin nuk ishte siguruar, sepse nuk ishte në listën e barnave të rimbursuara, duke pasur parasysh gjithashu faktin se ilaçi nuk ishte zëvendësuar me ndonjë ilaç ekivalent. Rrjedhimisht, në rastin konkret, qasja e kërkuesit në kujdes mjekësor falas, sikurse i takonte, nuk i ishte ofruar. Për një kohë ai kishte bartur koston e trajtimit, pavarësisht nga vendimet përfundimtare që i jepnin atij të drejtën për barnat e përshkruara pa pagesë dhe me përparsi. Aplikuesi kishte ndërruar jetë më 3 dhjetor 2006, ndërsa rastin e aplikimit e vazhdonte djali i tij.

GjEDNj-ja vëren se pavarësisht nga fakti që ankuesi kishte të drejtën për barna pa pagesë, kjo e drejtë i ishte kontestuar në mënyrë të përsëritur, kryesisht për arsyen burokratike, përkundër faktit se gjykatat e brendshme nuk kishin gjetur asnjë justifikim për sjelljen e autoriteteve shtetërore, aplikuesit nuk i ishte ofruar trajtimi i kërkuar, në kohën e duhur, gjë që kërkohet përsëritur të sëmundjes së tij.

Gjykata kishte vendosur se kishte pasur shkelje të nenit 2 të Konventës, pasi shtetit jo vetëm që i ndalohej të merrte jetë në mënyrë të paligjshme, por ishte gjithashu i detyruar t'i mbronte jetët e qytetarëve. Vonesa në ekzekutimin e vendimit të dhënë nga gjykatat e brendshme kishte çuar në një përkëqësim të shëndetit të kërkuesit. Gjykata kishte deklaruar më tej se ilaçi kishte një efekt pozitiv në shëndetin e kërkuesit dhe autoritetet ishin më se të vetëdijshme se me çfarë rreziku mund të përballej kërkuesi nëse nuk i ofroheshin ato barna.

Duhet përmendor këtu faktin se aplikuesi gjëzonë statusin e refugjatit, i përcaktuar me Ligjin nr. 189/2000, i cili parashikonte dëmshpërbirimin përsëri për personat e përndjekur etnikë, të cilët janë refugjatë nga territorët e pushtuara gjatë Luftës së Dytë Botërore. Seksioni 5 (a)

parashikonte që personat, rastet e të cilëve janë të rregulluara nga nenet 1 dhe 3: "Do të përfitojnë nga kujdesi mjekësor me përparësi dhe ilaçe pa pagesë si pacientë ambulatorë ashtu edhe kur shtrohen në spital."

Vendimi nr. 627/2005 i Qeverisë kishte ndryshuar Vendimin nr. 235/2005 lidhur me miratimin për vitin 2005 të listës së barnave, nga të cilat personat e siguruar që trajtoheshin si pacientë ambulatorë, me ose pa personel kontributi, mund të përfitonin në bazë të një recete mjekësore. Te personat e prekur nga ligjet e vecanta, të cilët kishin të drejtën e mjekimit falas të paguara nga Fondi Kombëtar i Sigurimeve Shëndetësore, kishin të drejtë të plotë rimbursimi të kostos së të gjitha barnave të përfshira në listë. Avastin nuk ishte përfshirë në listë.

Ankuesi gjithashtu ishte ankuar për diskriminim, duke e krahasuar rastin e tij me atë të përfituesve të tjerë me ligje të vecanta, si: oficerët e policisë, prokurorët, magjistratët, zyrtarë shteti dhe deputetë, të drejtat e të cilëve, sipas tij, konsideroheshin thelbësish më të rëndësishme se të drejtat e tij. GjEDNJ-ja konstaton se kërkuesi nuk kishte arritur të vërtetonte pretendimin se ai i ishte nënshtruar trajtimit diskriminues mbi bazën e statusit të tij shoqëror. Nga kjo rezulton se kjo ankesë ishte qartazi e pabazuar dhe duhej të refuzohej në përpunë me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

- *Nitecki kundër Polonisë (2002)*

Aplikuesi z. Zdzislaw Nitecki ishte një shtetas polak, i cili ishte diagnostikuar me sklerozë laterale amiotrofike (ALS), e njohur gjithashtu si sëmundja e Lou Gehrig. Në qershor të vitit 1999 atij i ishte dhënë ilaçi Rilutek për të trajtuar sëmundjen. Ai i bëri thirrje Fondit të Sigurimeve Shëndetësore që t'i rimbursoni shpenzimet e tij, duke vënë në dukje se, si pensionist, ai nuk mund ta përbollonte recetën e tij mujore. Kërkesa e tij ishte refuzuar me arsyetimin se Fondi kishte bërë rimbursimë të plota ose të pjesshme në bazë të regjistrave të publikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Sigurimeve Shoqërore dhe se, sipas regjistratit, kontributi i pacientit për Rilutec ishte 30%. Fondi nuk kishte "mundësi ligjore" për të siguruar një rimbursim përtëj kontributit ekzistues prej 70%. Z. Nitecki e kishte apeluar vendimin e Fondit, duke përsëritur se ai nuk mund t'i përbollonte kostot për ilaçin. Kërkesa e tij u ishte referuar Shërbimeve Sociale të Qarkut, e cila e kishte refuzuar kërkeshën. Gjatë disa javëve të ardhshme, z. Nitecki kishte marrë dy letra nga agencitë, të cilat përshkruanin arsyetimin përfuzimin. Zyra e Shërbimeve Sociale Bashkiake e kishte informuar atë se të ardhurat e tij totale të familjes i kalonin kufijtë e përcaktuar nga nen 4 (1) i Ligjit për Sigurimet Shoqërore, i cili nuk merrte në konsideratë kostot mjekësore dhe se departamentet e shërbimeve sociale kishin burime të kufizuara. Letra kishte rekomanduar gjithashtu që z. Nitecki të kërkonte një ndryshim e shkallës së aftësisë së kufizuar të tij në Bordin e Sigurimeve Shoqërore, gjë që mund të rezultonte në një "përsitim infermieror" shtesë. Ministria e Shëndetësisë dhe e Shërbimeve Sociale kishte konfirmuar vendimin e Fondit dhe kishte këshilluar se përpjekjet për të ulur normën e kontributit të pacientëve për Rilutek ishin të vazhdueshme, por në varësi të burimeve në dispozicion.

Statusi i aftësisë së kufizuar i z. Niteckit ishte rritur nga shkalla e dytë në të parën, në shtator 1999. Ai kishte apeluar në Gjykatën e Lartë, por ishte informuar se nuk kishte apelim. Z. Nitecki kishte paraqitur një ankesë në GjEDNJ duke pretenduar se refuzimi i rimburimit për çmimin e plotë të ilaçit që shpëton jetë kishte shkelur nenin 2 (E drejta

për jetë), nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GjEDNj-ja kishte shpallur unanimisht kërkuesën të papranueshme për të tria kërkuesat. GjEDNj-ja kishte vlerësuar se, në rrëthana të caktuara, vendimet e politikave të kujdesit shëndetësor mund të implikojnë detyrimet pozitive të një shteti sipas nenit 2 të Konventës për të mbrojtur jetën e qytetarëve të tij. Për shembull, rastet e kaluara kanë gjetur detyrime të nenit 2 në lidhje me kërkuesat e tregullores së spitalit, krijimin e sistemeve gjyqësore për zgjidhjen e pretendimeve për shkelje mjekësore dhe mohimin e kujdesit shëndetësor për individët kur kujdesi i ngashëm është në dispozicion për publikun e gjerë. Megjithatë, në rastin konkret, GjEDNj-ja kishte theksuar se kërkuesi nuk i ishte nënshtuar një standardi të ndryshëm kujdesi nga publiku i gjerë dhe se shteti kishte rimbursuar pjesën më të madhe të kostos së barit. GjEDNj-ja ishte shprehur se në këto rrëthana nuk mund të thuhet se shteti ka shkelur nenin 2 të KEDNj-së.

GjEDNj-ja vuri në dukje se nen 14 i KEDNj-së ndalon trajtimin e ndryshëm kur nuk ka asnjë justifikim objektiv ose të arsyeshëm për ta bërë këtë. Në rastin konkret, ku nuk ka prova të vendimmarjes arbitrale në lidhje me subvencionet individuale, GjEDNj-ja u shpreh se shteti kishte justifikuar vendosjen e masës në të cilën burimet e pakta financiare do të ndaheshin për subvencionet e shëndetit publik. GjEDNj-ja ka rikujtuar se nen 14 ndalon vetëm dallimet në trajtim, të cilat nuk kanë asnjë arsyetim objektiv apo të arsyeshëm. Megjithatë, GjEDNj-ja konstatoi se një justifikim i tillë ekziston në sistemin aktual të kujdesit shëndetësor, i cili bën zgjedhje të vështira për sa i përket masës së subvencionimit publik për të siguruar një shpërndarje të drejtë të burimeve të pakta financiare. GjEDNj-ja nuk ka gjetur asnjë provë për arbitraritet në vendimet që janë marrë në rastin e kërkuesit.

- Rasti Hristozov dhe të tjera kundër Bulgarisë (2012)

Aplikuesit ishin të gjithë pacientë me kancer me sëmundje terminale (katër prej tyre vdiqën pas paraqitjes se kërkësës në GjEDNj). Ata ishin përpjekur për të gjetur shërimin dhe kishin provuar shumë trajtime konvencionale, si: kimioterapia, radioterapia dhe terapia hormonale. Më pas ata i ishin drejtaruar një klinike private në Sofje dhe kishin zbuluar se një produkt eksperimental kundër kancerit ishte zhvilluar nga një kompani kanadeze dhe ishte lejuar në disa vende për sëmundje kërcënuese për jetën që nuk mund të trajtoheshin me sukses.

Kompania kishte aplikuar në Ministrinë buligare të Shëndetësisë për shpërndarje të produktit falas në këmbim të të dhënave përfshirë efektet e trajtimit. Aplikuesit kishin kërkuar leje për ta përdorur produktin, por ishin refuzuar me arsyetimin se produkti nuk ishte i autorizuar përfshirë përdorim në Bullgari. Kërkuesit ishin ankuar se kjo ishte një shkelje e nenit 2, e nenit 3 dhe e nenit 8 të Konventës.

GjEDNj-ja ishte shprehur se nuk kishte pasur shkelje të nenit 2, të nenit 3 dhe as të nenit 8 të Konventës. Në lidhje me nenin 2 të Konventës, duke theksuar se derisa nen 2 i imponon shtetit një detyrë përfshirë vendosur kornizën ligjore për të mbrojtur jetën e njerëzve, shteti nuk mund të përfshijë një detyrim përfshirë lejuar qasjen në një ilaç të paautorizuar dhe eksperimental. Në lidhje me nenin 3, GjEDNj-ja kishte deklaruar se, megjithëse moslejimi i qasjes në ilaç u kishte shkaktuar kërkuesve vuajtje shpirtërore.

nëni 3 nuk mund të thuhej se i impononte shtetit një detyrë për të barazuar dallimet midis kujdesit shëndetësor në dispozicion në vende të ndryshme.

VLERËSIM I AVOKATIT TË POPULLIT

45. Avokati i Popullit vëren se pacientët me melanomë, të cilat janë BRAF-pozitiv, aktualisht trajtohen me imunoterapi, e cila është në LBE, si dhe marrin kimioterapi në Klinikën Onkologjike. Përkundër faktit se dy vite me radhë kolegjumi i Klinikës Onkologjike ka dërguar kërkesa në Komitetin për Revidim të LBE-së në MSh përfunduar e terapisë "braf pozitiv" në LBE, si dhe vetë qëndrimi i drejtoreve të Klinikës Onkologjike, i cili njëherësh është edhe onkolog, se vendosja e terapisë "braf pozitiv" në LBE do të ndihmonte të sëmurët me melanomë të avancuar dhe, si profesionist shëndetësor, është pro futjes së terapive të avancuara në LBE në Kosovë, megjithatë, nga përgjigjja e MSh-së është kuptuar se me rastin e vendosjes së barnave të reja në LBE, merret përfunduar edhe kostoefektiviteti i tyre dhe kjo lë përfunduar se kosto financiare është fakti që kjo terapi nuk është në LBE.
46. Avokati i Popullit vëren se pacientët me karcinomë metastatike në mëlci trajtohen me terapi bazike përfunduar katër cikle të cilat janë në LBE, por përfunduar trajtimin shëndetësor me seancat e radhës, nuk u sigurohet imunoterapia "pembrolizumab", e cila është në LBE, por jo përfunduar trajtimin e kësaj sëmundjeje, rrjedhëmisht pacientët detyron ta sigurojnë vetë, në trugë ilegale.
47. Avokati i Popullit vëren se përfunduar trajtimi me fibrozë idiopatike pulmonare trajtimi në Klinikën Onkologjike bëhet me "kortikosteroide" me qëllim të zvogëlimit të progresivit të sëmundjes, e cila në fazat e avancuara të pacientët shkakton insuficiencë të rëndë respiratore. Avokati i Popullit, në bazë të përgjigjeve që ka pranuar nga autoritetet, mëson se së fundmi nga Agjencia përfunduar Ushqim dhe Barna e ShBA-së janë aprovuara barnat antifibrotike përfunduar zvogëlimin e përkohësimit të sëmundjes. Përderisa terapia me kortikosteroide gjendet në LBE, barnat antifibrotike të aplikuara vitezë të fundit te pacientët me fibrozë idiopatike pulmonare, përfunduar shkak të kostobenefitit të tyre, nuk gjenden në LBE.
48. Nga praktika e GjEDNj-së vërehet se ekzistojnë sisteme të ndryshme të ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe se shteteve u lejohet një hapësirë e vlerësimit përfshirjen e ilaçeve që ofrohen falas. GjEDNj-ja ka gjetur shkelje në rastin kur ilaci nuk ishte zëvendësuar me ndonjë ilaç ekuiivalent. GjEDNj-ja ka vlerësuar se shteteve nuk mund t'u imponohet një detyrë përfunduar trajtimi të parabartë apo diskriminim. GjEDNj-ja nuk ka gjetur në asnjëri prej rasteve të trajtuara më sipër se ka pasur diskriminim.
49. Përfunduar trajtimi përfshira me ankesave që kemi pranuar, Avokati i Popullit vëren se pacientëve u ofrohet një illoj terapi falas, por e cila duket se nuk është mjafueshëm efektive përfunduar trajtimi e sëmundjeve. Avokati i Popullit bazohet edhe në rekomandimet e mjekëve ekspertë se përfunduar trajtimi e sëmundjeve të sipërpërmendura tanimë ekzistojnë ilaçe më të avancuara e të cilat nuk janë të përfshira në LBE.
50. Avokati i Popullit vlerëson faktin se ka rritje të buxheti përfunduar trajtimi e natyrës onkologjike, megjithatë, duke marrë parasysh qëndrimet e Kolegjit të Klinikës Onkologjike, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishme dhe mjaft të nevojshme qasjen e pacientëve në shërbimet më të avancuara shëndetësore.

51. Avokati i Popullit sjell në vëmendjen e autoriteteteve faktin se KEDNJ-ja është një instrument i gjallë që duhet interpretuar sipas kushteve të sotme e që është tipar qendror i praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së që nga ditët e para. GjEDNJ-ja e përdor interpretimin evolutiv, duke parë jurisprudencën përkatëse dhe se si ajo është zhvilluar me kalimin e kohës. Interpretimi evolutiv i KEDNJ-së është thelbësor për të drejtat e njeriut. Fakti se GjEDNJ-ja në shumicën e rasteve të përmendura më sipër nuk ka gjetur shkelje dhe as diskriminim, nuk paraqet ndonjë qëndrim të ngurtë, i cili nuk do të mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt, për shkak se me zbulimin e ilaçeve të avancuara, shtetet nuk mund të arsyetohen se kanë ofruar ilaçe dhe shërim falas në rast se këto ilaçe nuk kanë ndonjë efekt pozitiv në shëndetin dhe jetën e qytetarëve.

52. Prandaj, duke pasur parasysh rrëthanat e theksuara më sipër, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Shëndetësisë:

- Ta plotësojë/ndryshojë Listën e Barnave Esenciale dhe të përfshijë në këtë listë terapitë:
 - "braf pozitiv" për të sëmurët me melanomë të avancuar;
 - "Pirfenidone-267 mg" për të sëmurët me fibrozë idiopatike pulmonare.
- T'ua mundësojë të sëmurëve me karcinomë metastatike në mëlçi qasjen falas në imunoterapiën "pembrolizumab", që është në listën e barnave esenciale.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("*Ka të drejtë te bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete. [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.*"), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.


Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit